

V E N D I M
Nr.370, datë 8.8.1994

PËR CAKTIMIN E TARIFAVE TË REGJISTRIMIT TË BARNAVE

Në mbështetje të ligjit nr.7815, datë 20.4.1994 “Për barnat” me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe të Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I :

1. Për regjistrimin e barnave në vendin tonë paguhen tarifat e regjistrimit për çdo dozë të specialiteteve të prodhuara në vend ose të importuara, përkatësisht si vijon:

a) Për barnat të cilat përfshihen në “emërtesën e barnave në fuqi”, si dhe në “listën e barnave thelbësore” të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit, kur importohen paguhet tarifa në lekë e kundërvleftës së 200 dollarëve amerikanë dhe kur janë të prodhuara në vend paguhet tarifa në lekë e kundërvleftës së 50 dollarëve amerikanë.

b) Për barnat të cilat nuk përfshihen në emërtesën dhe listën e barnave thelbësore në fuqi të importit ose të prodhuara në vend paguhet tarifa në lekë e kundërvleftës së 500 dollarëve amerikanë.

2. Pagesa e tarifave të regjistrimit të barnave të caktuara sipas pikës 1 të këtij vendimi kryhet nga fabrikuesit e barnave ose përfaqësuesit e autorizuar prej tyre në Qendrën Kombëtare të Kontrollit të Barnave.

Këto janë të vlefshme për një periudhë 5-vjeçare duke filluar nga data e regjistrimit (pagimit) të tyre.

3. Të ardhurat që sigurohen nga zbatimi i tarifave të regjistrimit të barnave të derdhen në masën 30 për qind në buxhetin e shtetit dhe 70 për qind të përdoren nga vetë institucioni.

4. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ministria e Financave të nxjerrin udhëzimin përkatës në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi më 16 gusht 1994.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi